# MODELI I PARTNERITETIT

## NDËRMJET SHKOLLAVE PËRMES AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA NDËRKULTURORE

Pestalozzi Children's Village

Служба Координационог тела Владе Републике Србије
за општине Прешево, Бујановац и Медвеђа

GRUPA

**Botues**

Shërbimi i Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë
për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe Grupi 484

**Redaktore**

Ivana Seratliq

**Autor**

Vanja Shtulliq

**Konsulent profesional**

Sasha Gllamoçak

**Lektura**

Brankica Zhivkoviq (teksti në gjuhën serbe)

Fidan Fejzulli dhe Fatos Mustafa (teksti në gjuhën shqipe)

**Përkthimi**

Fidan Fejzulli dhe Fatos Mustafa

**Dizajni**

Sonja Ristiq

**Emri dhe selia e shtypshkronjës**

Copy Planet, Beograd

**Tirazhi**

80

**Vendi dhe viti i botimit**

Beograd, 2025

Të gjithë termat e përdorur në këtë publikim në gjininë mashkullore përfshijnë si gjininë mashkullore ashtu edhe atë femërore, dhe i referohen të gjithë personave pa dallim gjinie.

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit për Fëmijë Pestalozzi, i cili ka mbështetur botimin e këtij materiali.

# Përmbajtja


Ideja themelore e udhëzuesit për aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore.....4

"Na ishte (vërtet) bukur" - udhërrëfyes për aktivitete të përbashkëta ndërkulturore.....5

"Çfarë është realizuar?"- përshkrimi dhe rezultatet e projektit "Qyteti ynë, shkollat tona".....7

"Pse jemi mbledhur?" - përkufizimi i aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore.....8

"Çfarë përfitojmë ne?" - përfitimet e konfirmuara për pjesëmarrësit në aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore.....11

"Çfarë mund të bëjmë së bashku?" – krahasimi i llojeve të ndryshme të aktiviteteve të përbashkëta..... 12

„Si duket nga përvoja e drejtpërdrejtë?" – përvoja e pjesëmarrësve si bazë për udhëzime....15

Lista kontrolluese për përgatitjen, realizimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të përbashkëta....18

1. Përgatitja e aktivitetit.....18
2. Zhvillimi i aktivitetit.....20
3. Vlerësimi dhe reflektimi.....22

"Çfarë është ora e përbashkët?" – udhëzime edukativo-pedagogjike (shembull i orës së përbashkët).....23

Rekomandime për përgatitje të suksesshme të orës së përbashkët.....24

Përshtatja e indikatorëve të suksesit për orën e përbashkët.....25

Formulari përcjellës për ndjekjen e orës së përbashkët në kontekst ndërkulturor.....27

Përkujtues i shkurtër për vetëvlerësimin e orës së përbashkët nga dyshet e mësimdhënësve.....29

Hapat për vlerësim përmes shkëmbimit horizontal.....30

Gjithçka që nuk u përfshi në tabela, por e kemi mësuar nga përvoja.....32

Pesë propozime të literaturës së dobishme për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme të përbashkëta.....37

# IDEJA THEMELORE E UDHËZUESIT PËR AKTIVITETET E PËRBASHKËTA NDËRKULTURORE

Nëntë vite të projektit "Qyteti ynë, shkollat tona" kanë rezultuar me krijimin e Modelit të partneritetit ndërmjet shkollave – përmes aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore (në vazhdim: Modeli i partneritetit ndërmjet shkollave). Ky model është konceptuar për të nxitur dhe fuqizuar vlerat dhe praktikat e arsimit ndërkulturor, duke zhvilluar një rrjet bashkëpunimi ndërmjet shkollave në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë – ndërmjet shkollave ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe dhe atë shqipe.Bashkëpunimi ndërmjet këtyre shkollave është realizuar në forma të ndryshme – përmes takimeve të përbashkëta, seminareve, punëtorive, ekskursioneve, aksioneve publike, vizitave studimore, botimeve. Të gjitha këto aktivitete kanë përfshirë shumë pjesëmarrës – nxënës, mësimdhënës, fasilitatorë, koordinatorë, drejtorë, prindër, mentorë.Aktivitetet thelbësore të tërë projektit kanë qenë ato ndërkulturore të përbashkëta, ku mësimdhënësit kanë menduar mënyra se si, përmes bashkëpunimit me një shkollë tjetër, ideja e ndërkulturalitetit të bëhet e afërt për të gjithë nxënësit. Pas shumë aktiviteteve të përbashkëta të realizuara gjatë këtyre nëntë viteve, ka ardhur koha që njohuritë e mbledhura të përmblidhen dhe ndahen edhe një herë.Ky udhëzues i shkurtër është shkruar pikërisht me qëllim që të gjithë mësimdhënësit e interesuar të mund të vazhdojnë dhe të zhvillojnë më tej atë që është mësuar nga projekti "Qyteti ynë, shkollat tona".

Aktivitetet e përbashkëta në kuadër të projektit kanë nënkuptuar kryesisht bashkëpunimin ndërmjet dy ose tre shkollave partnere – shkolla ku arsimi zhvillohet në gjuhën serbe dhe shkolla ku arsimi zhvillohet në gjuhën shqipe. Çiftet e shkollave partnere janë formuar në bazë të afërsisë gjeografike, përvojave të mëparshme të bashkëpunimit dhe motivimit të shprehur nga mësimdhënësit dhe udhëheqësit për t'u përfshirë në aktivitete të përbashkëta. Procesi i çiftëzimit të shkollave partnere ka filluar në vitin 2021, në kuadër të fazës së dytë të projektit, dhe janë formuar gjithsej pesë çifte shkollash partnere, ndër të cilat janë, për shembull:

- SHF "Naim Frashëri" dhe SHF "Branko Radiçeviq"
- SHF "Dragomir Trajkoviq", SHF "Muharem Kadriu" dhe SHF "Desanka Maksimoviq"
- SHF "Ali Bektashi" dhe SHF "Vuk Karaxhiq"
- SHF "Bora Stankoviq" dhe SHF "Sami Frashëri"
- SHML "Sveti Sava" dhe SHML "Sezai Suroi"

Në fazat e ardhshme të projektit, ky model i lidhjes ka shërbyer si bazë për përfshirjen e shkollave të tjera në rrjetin e bashkëpunimit ndërkulturor nga Medvegja (SHMP "Nikola Tesla") dhe Presheva (Gjimnazi "Skënderbeu" dhe Shkolla Teknike "Presheva").

Është e rëndësishme të theksohet se aktivitetet e përbashkëta mund të zhvillohen edhe brenda së njëjtës shkollë apo edhe të njëjtës klasë, në varësi të kontekstit arsimor dhe profilit të nxënësve. Është përgjegjësi e komunitetit shkollor që aktivitetet e përbashkëta t'i përshtasë me planin dhe programin mësimor të paraparë. Kështu, aktivitetet e përbashkëta mund të realizohen në kuadër të orëve të modeluara, programeve të aktiviteteve të lira, aktiviteteve fakultative, mësimit përmes projekteve, ekskursioneve, apo aksioneve të parlamenteve shkollore.

Ky publikim është kryesisht i dedikuar për mësimdhënësit, por mendojmë se mund t'u shërbejë edhe të gjithë të tjerëve që janë të përfshirë në procesin arsimor – nga punonjësit e shkollave deri te institucionet publike dhe komuniteti më i gjerë. Udhëzuesi është shkruar me qëllim që mësimet e deritanishme mbi aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore të paraqiten në mënyrë sa më të dobishme dhe praktike për të gjithë aktorët e interesuar.E kemi imagjinuar këtë udhëzues si një mbështetje për drejtorin e shkollës që dëshiron të përkrahë mësimdhënësit në realizimin e aktiviteteve ndërkulturore të përbashkëta; për përfaqësuesin e komunës që dëshiron të sigurojë në mënyrë të duhur kushtet e nevojshme për këto aktivitete; për prindin e motivuar që dëshiron të kuptojë më mirë në çfarë po merr pjesë fëmija i tij. Prandaj, ky publikim mund të përdoret në mënyra të ndryshme dhe në renditje të ndryshme – shpresojmë që për disa të shërbejë si listë kontrolli, për të tjerët si model për ndjekjen e një ore të përbashkët, dhe për disa si përmbledhje e përfitimeve të veçanta të aktiviteteve të përbashkëta. I kemi kushtuar vëmendje të veçantë krijimit të burimeve të përshtatshme që mund t'u ndihmojnë mësimdhënësve që duan të mbajnë për herë të parë një orë të përbashkët.

## NA ISHTE (VËRTET) BUKUR" – udhërrëfyes për aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore

Kur punojmë në Bujanoc, Medvegjë dhe Preshevë, kënaqësia është gjithmonë e madhe për shumë arsye. Arsyeja më e rëndësishme janë të rinjtë, të cilët me pjesëmarrjen, veprimet, idetë dhe ndryshimet e tyre dëshmojnë se ia vlen të merresh me arsimin ndërkulturor. Sado që ne, si të rritur, e shijojmë procesin e krijimit, mbështetjes dhe përcjelljes së këtij rrugëtimi, kuptimi thelbësor i të gjitha aktiviteteve të përbashkëta fshihet në përgjigjen ndaj pyetjes që e bëjmë në fund – "Si ju kaloi?". Dhe përgjigjja që dallohet bindshëm është: "Na ishte bukur". Pikërisht e formuluar kështu, në shumës, shpesh me një theks emocional – vërtet bukur! Vërtet bukur pas aksioneve në rrugë, vërtet bukur pas orës së përbashkët, vërtet bukur pas kthimit nga Zvicra… Duke besuar se kjo përgjigje pasqyron vlerat dhe parimet e arsimit ndërkulturor, shpesh pyesim veten çfarë fshihet pas këtij pohimi (të bukur). Çfarë i bën të ndihen bukur dhe pse, si mund ta zgjasim atë ndjesi dhe ta bëjmë edhe më të bukur, a e përjetojnë të gjithë njësoj, kur dhe pse nuk është bukur, a është vetëm bukur apo edhe diçka tjetër, çfarë do të thotë në të vërtetë "bukur" për këdo, si të jemi të sigurt se jemi përgatitur mjaftueshëm që të jetë bukur për ta, çfarë do të thotë kjo ndjesi për komunitetin ku jetojnë, si mund ta bartin këtë bukuri edhe jashtë aktiviteteve

të përbashkëta… Këto pyetje ua drejtojmë drejtpërdrejt të rinjve, por pas një përgjigjeje shpesh të shkurtër dhe tipike për adoleshentët, ia drejtojmë vetes. Me dëshirën për të gjetur një përgjigje sistematike, të saktë, praktike dhe mjaftueshëm gjithëpërfshirëse për këto pyetje, u përfshimë në një hulumtim gjatë fazës së fundit të projektit (2023–2025). E nisëm me kureshtje dhe me dëshirën për të mbledhur përvoja të ndryshme, por edhe me vetëbesim, falë njohjes shumëvjeçare të cilësisë së punës së shumë njerëzve të përfshirë në projektin "Qyteti ynë, shkollat tona". Detyra jonë ishte të dëgjojmë, të mbledhim dhe të lidhim. Në hulumtim morën pjesë gjithsej 63 pjesëmarrës: 29 të rritur (prej të cilëve 55% ishin nga menaxhmenti shkollor, 30% mësimdhënës dhe 20% prindër) dhe 34 nxënës. Hulumtimi u zhvillua në tri faza, duke përdorur një qasje pjesëmarrëse dhe cilësore, ku përmes intervistave, grupeve fokale, diskutimeve me pjesëmarrësit dhe testimeve në praktikë, rezultatet u plotësuan gradualisht. Faza e parë përfshiu intervista dhe grupe fokale me pjesëmarrësit dhe realizuesit e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe analizën e të dhënave të mbledhura dhe nxjerrjen e rezultateve të para dhe udhëzimeve për aktivitetet e përbashkëta.Faza e dytë përfshiu testimin dhe plotësimin e udhëzimeve në bashkëpunim me shkollat partnere, ndërsa faza e tretë iu kushtua hartimit të dokumentit praktik – Modelit të partneritetit ndërmjet shkollave, i cili ndodhet para jush.

Ky udhëzues dëshirojmë të jetë njëherësh edhe dëshmi edhe frymëzim – si për ata që tashmë janë të përfshirë, ashtu edhe për ata që sapo po mendojnë për hapin e parë drejt arsimit ndërkulturor. Materiali është i destinuar për përdorim praktik, prandaj përmban udhëzime, lista kontrolli dhe shembuj konkretë nga përvojat e pjesëmarrësve, me qëllim që aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore të bëhen pjesë e përditshme e punës dhe atmosferës shkollore, e jo vetëm projekte të rastësishme.

Duke ndjekur gjurmët e praktikave të mëparshme dhe përvojave të bashkëpunëtorëve tanë, shpresojmë që ky udhëzues t'ju ftojë qartë dhe me zë të lartë:

## "Hajde së bashku ta bëjmë vërtet bukur!"

# "ÇFARË ËSHTË REALIZUAR?" – përshkrimi dhe rezultatet e projektit "Qyteti ynë, shkollat tona"

Shërbimi i Trupit Koordinues të Qeverisë së Republikës së Serbisë për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, së bashku me Grupin 484, që nga viti 2017 zbatojnë projektin "Qyteti ynë, shkollat tona" në Bujanoc, me mbështetjen e Fondacionit për Fëmijë Pestalozzi. Gjatë shtatë viteve të fundit është realizuar bashkëpunim me 2 shkolla të mesme dhe 9 shkolla fillore në Bujanoc, ndërsa nga viti 2023 projekti është zgjeruar edhe në 3 shkolla të mesme të tjera (2 në Preshevë dhe 1 në Medvegjë).Qëllimi kryesor i projektit është nxitja e interaksionit dhe bashkëpunimit ndërmjet fëmijëve nga komunitete të ndryshme etnike, si dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe dhe atë shqipe.Rreth 400 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme kanë ndjekur seminare ku kanë përmirësuar kompetencat e tyre për mësimdhënie ndërkulturore, zhvillimin e mësimit cilësor dhe aftësive (ndër)kulturore e shoqërore të të rinjve përmes programit mësimor dhe aktiviteteve jashtëshkollore, gjë që ka kontribuar që mbi 5.000 nxënës të marrin mësim më cilësor dhe më nxitës.Më shumë se 1.700 nxënës kanë përmirësuar kompetencat e tyre ndërkulturore përmes punës direkte – duke marrë pjesë në projekte të vogla hulumtuese, punëtori, aksione në hapësira publike dhe iniciativa të parlamenteve të nxënësve që kanë nxitur solidaritetin dhe respektin e ndërsjellë në komunitetet lokale. Përveç kësaj, 200 nxënës kanë marrë pjesë në shkëmbime ndërkulturore me bashkëmoshatarë nga Evropa në Fshatin e Fëmijëve Trogen në Zvicër.

Në fillim, edhe për ne dukej pothuajse e pamundur të organizonim orë të përbashkëta dhe aktivitete të përbashkëta ndërmjet shkollave, për shkak të largësisë fizike dhe barrierës gjuhësore. **Edhe pse fillimisht kishim planifikuar vetëm nga 1 orë të përbashkët në vit, arritëm deri në 25+ orë, pastaj 12 projekte shkollore dhe mbi 30+ aksione të parlamenteve të nxënësve – falë arsimtarëve që me energjinë, përkushtimin dhe shembullin e tyre kultivojnë vlera ndërkulturore.** Këto rezultate nuk erdhën brenda natës – ato u zhvilluan fazë pas faze gjatë tre fazave të projektit, secila prej të cilave zgjati nga tre vjet.

**Mesazhi është i qartë: kur bashkohemi, lindin shembuj të bashkëpunimit të suksesshëm. Le të kujdesemi për njerëzit që bëjnë ndryshimin. Dhe nëse diçka nuk funksionon që në fillim, kjo nuk do të thotë se nuk ia vlen – por se kërkon të mësuar, përshtatje dhe këmbëngulje.**

Për zhvillimin afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e aktiviteteve të tilla, mbështetja e komunitetit lokal është e rëndësishme – nga shkollat dhe prindërit, deri te shërbimet komunale dhe institucionet. Kur të gjithë aktorët përfshihen dhe e njohin rëndësinë e bashkëpunimit ndërkulturor, krijohet baza që këto praktika të bëhen pjesë e kulturës së përhershme të punës dhe jetës në komunitet. Në këtë mënyrë, mjediset tona mund të bëhen të njohura për bashkëpunim, hapje dhe qasje inovative në arsim.

# "PSE JEMI MBLEDHUR?" – përkufizimi i aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore

Orët e përbashkëta, projektet dhe aksionet nuk kanë qenë thjesht ngjarje të veçuara, por janë shndërruar në mënyrë të njohur të punës dhe takimit. Pikërisht për këtë arsye, në vazhdim të këtij kapitulli përkufizojmë konceptin e aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore, format e tyre, qëllimet dhe parimet që janë dëshmuar si kyçe në zhvillimin dhe zbatimin e tyre.

- **Aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore** ndërmjet shkollave partnere nënkuptojnë veprimtari ku marrin pjesë grupe të përziera etnike të përbëra nga mësimdhënës, nxënës, komuniteti shkollor dhe ai më i gjerë, me qëllim zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Aktivitetet mund të jenë të ndryshme: takime të përbashkëta, orë mësimore, punëtori, projekte shkollore, ekskursione…

Dy aspekte kryesore dhe të pandashme të një aktiviteti të përbashkët ndërkulturor janë:

1. Pjesëmarrja e grupeve të përziera etnike:

- Përfshin: nxënës (të shkollave fillore dhe të mesme ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe dhe shqipe), të rinj, mësimdhënës, prindër, lehtësues, komunitetin më të gjerë (vëllezër dhe motra të pjesëmarrësve, miq, fqinj, të afërm, qytetarë…). Nuk është e domosdoshme që të përfshihen të gjithë aktorët, por përzierja etnike gjatë aktiviteteve të përbashkëta është element kyç, sepse pasqyron dhe modelon jetën "reale" të komuniteteve të përziera etnike – jetën jashtë kontekstit shkollor. Cilësia e këtij bashkëjetese, në mjedise gjithmonë ndërkulturore, mbështetet në respektin e ndërsjellë, lidhjen dhe të mësuarit së bashku.

Shpesh është e përhapur bindja se për një aktivitet të përbashkët ndërkulturor mjafton që pjesëmarrësit të jenë nga grupe të përziera etnike. Edhe pse ky është një element shumë i rëndësishëm, qëllimi edukativo-arsimor i aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore nuk është vetëm veprimtaria e përbashkët, por ajo që synon zhvillimin e kompetencave specifike ndërkulturore. Me fjalë të tjera, njëaktivitet i përbashkët ndërkulturor është i suksesshëm vetëm kur pjesëmarrësit jo vetëm kalojnë kohë së bashku, por edhe fitojnë aftësi konkrete dhe kuptim që u mundëson të funksionojnë më cilësisht në një komunitet multikulturor.

2. Zhvillimi i kompetencave ndërkulturore nënkupton:

- Fitimin e njohurive dhe kuptimit për kulturën tjetër (gjuhën, tregimet, vlerat, zakonet, veçoritë...);

- Vërejtjen e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet komuniteteve të ndryshme;

- Zhvillimin e vlerësimit pozitiv të dallimeve, respektimin e tyre si pasuri dhe burim për të

mësuar;

- Zhvillimin e ndjeshmërisë ndaj të tjerëve dhe të ndryshmëve, si dhe një kuptim më të thellë të identitetit personal;
- Zhvillimin e qëndrimeve që angazhohen aktivisht për solidaritet, bashkëpunim, barazi dhe demokraci;
- Formimin e hapjes (kognitive dhe emocionale) dhe kureshtjes ndaj anëtarëve të grupeve të tjera etnike – dhe më gjerësisht, ndaj çdo grupi që dallon nga i vetmi, p.sh. gjuhësor, fetar, gjinor, ekonomik – si dhe, për shembull, muzikor.

Qasjet bashkëkohore ndaj arsimit ndërkulturor theksojnë se është e domosdoshme që idetë e ndërkulturalitetit të lidhen me rrethanat më të gjera shoqërore. Kjo do të thotë se zhvillimi i kompetencave ndërkulturore nënkupton edhe zhvillimin e një qëndrimi të angazhuar ndaj ndryshimeve shoqërore që kundërshtojnë çdo formë padrejtësie dhe diskriminimi. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të shqyrtohen në mënyrë kritike kushtet shoqërore që krijojnë pengesa ndërmjet kulturave të ndryshme. Me fjalë të tjera, aktivitetet ndërkulturore nuk janë thjesht ngjarje të veçanta, por hapa drejt krijimit të një kulture respekti dhe bashkëjetese ndërmjet gjuhëve, identiteteve dhe përvojave të ndryshme – që të bëhet pjesë e jetës së përditshme në shkollë. Siç na kanë thënë pjesëmarrësit në hulumtim, atmosfera ndërkulturore e shkollës është një hap i natyrshëm dhe logjik në komunitete etnikisht të larmishme si Bujanoci, Medvegja dhe Presheva.



## Qëllimet themelore të aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore:

- Zhvillimi i qasjes ndërkulturore brenda komunitetit shkollor;
- Rritja e bashkëpunimit ndërkulturor ndërmjet disa komuniteteve shkollore;
- Nxitja dhe kultivimi i vlerave ndërkulturore në komunitetin më të gjerë.

## Parimet kyçe të aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore

- **Takim dhe dialog –** aktivitetet krijojnë një hapësirë të sigurt për shkëmbim dhe të mësuarit për njëri-tjetrin.
- **Barazi dhe respekt –** të gjithë pjesëmarrësit kanë zë, kontribut dhe vlerë të barabartë në procesin e përbashkët.
- **Krijim i përbashkët –** aktivitetet konceptohen dhe zbatohen së bashku; përmes bashkëpunimit lind ndjenja e bashkësisë dhe përgjegjësisë.
- **Mësim përmes përvojës –** njohuritë dhe lidhjet krijohen përmes lojës, hulumtimit dhe punës së përbashkët.
- **Dukshmëria e dallimeve –** gjuhët dhe kulturat e ndryshme shndërrohen në burim dhe pasuri të hapësirës së përbashkët.
- **Qëndrueshmëria –** qëllimi nuk është një ngjarje e vetme, por praktikë afatgjatë dhe lidhje të qëndrueshme ndërmjet shkollave dhe komuniteteve.
- **Reflektim dhe të mësuarit nga përvoja –** çdo aktivitet përmbyllet me ndarjen e përshtypjeve dhe të mësuarit nga ajo që kemi përjetuar së bashku.

# "ÇFARË PËRFITOJMË NGA KJO?" – përfitimet e konfirmuara të pjesëmarrësve në aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore

Siç është përmendur më parë, aktivitetet e përbashkëta synojnë zhvillimin e kompetencave ndërkulturore. Gjatë planifikimit të aktiviteteve, është shumë e dobishme të kemi parasysh rezultatet e dëshiruara në fushën e arsimit ndërkulturor. Rezultatet specifike për shkollat fillore dhe të mesme janë përshkruar në mënyrë të detajuar në publikimin e mëparshëm Udhëzues për arsimin ndërkulturor *(faqet 31–33)*, ndërsa linkun për Udhëzuesin gjendet në fund të tekstit.

Në tabelën e mëposhtme janë përzgjedhur përfitimet më të shpeshta që pjesëmarrësit e mëparshëm të aktiviteteve të përbashkëta i kanë identifikuar dhe vërejtur te vetja. Kjo tabelë mund të shërbejë si nxitje (vetë)motivimi për t'u përfshirë në aktivitete të përbashkëta, duke ofruar një përgjigje të qartë për pyetjen: pse ka kuptim të angazhohemi në këtë formë të veprimit?.

| | |
|---|---|
| **Nxënësit** | • Krijimi i njohjeve dhe miqësive të rejau<br>• Mësimi i gjuhëve *(anglisht, serbisht dhe shqip)*<br>• Njohja me kulturën tjetër<br>• Zhvillimi i vetëbesimit dhe proaktivitetit<br>• Zhvillimi i pavarësisë<br>• Zhvillimi i aftësive sociale *(orientimi në situata të panjohura)*<br>• Zhvillimi i empatisë dhe aftësisë për të parë nga perspektiva të ndryshme<br>• Zhvillimi i aftësive specifike *(aktrim, film, pikturë, muzikë, paraqitje publike, sport…)*<br>• Kalimi i kohës së lirë në mënyrë të strukturuar, të këndshme dhe të frytshme<br>• Forcimi i ndjenjës së përkatësisë në komunitet<br>• Zhvillimi i fleksibilitetit dhe kreativitetit në ndërveprime<br>• Kuptim më i thellë i identitetit personal dhe zgjedhjeve individuale |
| **Arsimtarët** | • Zhvillim profesional<br>• Shkëmbim horizontal me kolegë të tjerë<br>• Përdorimi i qasjeve të reja në mësimdhënie<br>• Mundësi për të provuar mjete didaktike-metodike alternative<br>• Pasurim i përvojës mësimore<br>• Mbështetje mentorimi nga mësimdhënës/ekspertë më me përvojë<br>• Përmirësim i kompetencave ndërkulturore të mësimdhënësve<br>• Rrjetëzim profesional<br>• Ndjenjë përkatësie ndaj shkollës dhe komunitetit<br>• Thellim i marrëdhënieve të respektit dhe mirëkuptimit me nxënësit<br>• Vlerësim i shtuar në komunitetin lokal<br>• Zgjerim i perspektivës personale |

| | |
|---|---|
| **Shkolla** | • Arsim më gjithëpërfshirës<br>• Klimë pozitive në shkollë<br>• Arritja e kompetencave ndërlëndore<br>• Lehtësim i lidhjes ndërmjet përmbajtjeve mësimore<br>• Përgatitje e mirë për proceset e vlerësimit dhe vetëvlerësimit<br>• Zgjerim dhe freskim i shembujve të praktikave të mira<br>• Krijimi i një atmosfere besimi dhe sigurie<br>• Kohezion dhe pjesëmarrje më e madhe në komunitetin lokal<br>• Zhvillim i potencialeve të nxënësve *(ndërpersonale, sportive, artistike)*<br>• Rritje e interesimit dhe mbështetjes së prindërve për aktivitetet e përbashkëta<br>• Zgjerim i bashkëpunimit dhe mbështetjes ndërmjet shkollave<br>• Mbështetje mediatike dhe lokale |

# "ÇFARË MUND TË BËJMË SË BASHKU?" – pasqyrë krahasuese e formave të ndryshme të aktiviteteve të përbashkëta

Aktivitetet e përbashkëta mund të marrin forma të ndryshme, varësisht nga qëllimet, koha dhe konteksti. Në tabelën më poshtë paraqiten disa nga format më të zakonshme, të cilat tashmë janë bërë pjesë e praktikës së përditshme në skenat shkollore ndërkulturore në Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë. Këto janë: orët e përbashkëta, projektet shkollore, punëtoritë dhe aksionet e parlamenteve të nxënësve. Tabela paraqet karakteristikat themelore të secilës formë, të cilat mund të ndihmojnë në planifikimin e aktiviteteve. Nuk është një listë e plotë e të gjitha mundësive, por një përmbledhje e formateve të provuara – një hap i sigurt për fillimin e ideimit të formave të ngjashme apo të reja të punës së përbashkët.

| | Orë të përbashkëta | Projektet shkollore | Punëtori | Aksione të parlamenteve të nxënësve |
|---|---|---|---|---|
| **Kohëzgjatja** | Një (në klasat e ulëta) ose dy orë mësimore | Disa javë, disa muaj, fleksibël | Rreth tre orë (me pushim) | Sipas nevojës (fushata, ditë aksionesh) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kush e udhëheq aktivitetin** | Arsimtarët në çift dygjuhësh | Arsimtarë me nxënësit, iniciator shkollor i projektit | Arsimtarë, bashkëpunëtorë profesionalë, lehtësues të jashtëm | Nxënësit (parlamenti), me mbështetjen e arsimtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë |
| **Roli i nxënësve** | Pjesëmarrës aktivë në mësim, përfaqësues të trashëgimisë kulturore | Hulumtues, autorë, organizatorë, propozues, ftesues | Aktivë në ndërveprim dhe shprehje; mund të jenë nismëtarë të rrjedhës, temës, mënyrës, përmbajtjes | Nismëtarë, organizatorë, zbatues |
| **Vendi i realizimit** | Klasa në shkollën pritëse | Klasa, terren, hapësirë shkollore, online, shesh publik, Zyra për të rinj | Në shkollë ose jashtë saj; hapësira universitare; Zyra për të rinj | Shkollë, komunitet lokal, qytet fqinj, vende të veçanta |
| **Përgatitjet e nevojshme** | Përgatitje për orën, marrëveshje ndërmjet arsimtarëve, mbështetje nga kolektivi dhe drejtori | Plan i detajuar dhe ndarje rolesh, mbështetje nga komuna dhe kolektivi shkollor | Materiale, hapësirë, lehtësim | Logjistikë, promovim, pëlqim nga prindërit për pjesëmarrje të fëmijëve dhe për fotografim |
| **Përfshirja e akterëve** | Nxënës, arsimtarë, bashkëpunëtorë profesionalë, prindër | Nxënës, arsimtarë, prindër, komuniteti | Ekspertë, artistë, shkencëtarë, misafirë, "të huaj e vendas" | Udhëheqësia e shkollës, mediat, komuniteti |
| **Produktet e dukshme** | Përgatitje e përbashkët për orën, përshtypje të materializuara nga ora | Prezantim, ekspozitë, broshurë, video | Aksione publike; ekspozita; performanca avokuese; lojëra shoqërore, objekte artistike | Fushatë avokuese për ndryshim në komunitet, p.sh.: riparimi i stolave në park, grafit miqësie |
| **Shembuj** | "Ninullat në gjuhën shqipe, rome dhe serbe" | Çiklizmi është në modë | "Më trego – do ta gjej" | Kampi veror në Nish; Panairi humanitar i punimeve artizanale; aksione ekologjike, lojëra sportive |
| | *Link:* *http://skr.rs/zSDi* | *Link (pjesë nga atmosfera):* *https://is.gd/HlRpMD* | *Link:* *http://skr.rs/zSDi* | *Link (pjesë nga atmosfera):* *https://is.gd/v4Q2vf* |

## SHEMBULL I PRAKTIKËS SË MIRË

Projekti shkollor “Çiklizmi është në modë”, i realizuar nga shkollat fillore “Branko Radiçeviq” dhe “Naim Frashëri”, përfshiu aksionin përmbyllës në rrugë “Rrethi i Bujanocit” (shëtitje me biçikleta nëpër qytet), i cili bashkoi nxënësit, prindërit dhe komunitetin e gjerë përmes një teme bashkëkohore dhe të përditshme – çiklizmit. Aktiviteti ishte i suksesshëm pasi që bashkoi gjenerata të ndryshme përmes interesave të përbashkëta, mundësoi zbatim praktik në jetën e përditshme dhe promovoi stil të shëndetshëm jetese dhe ruajtjen e shëndetit mendor. Prindërit theksuan: “Fëmijët na treguan me entuziazëm për aksionin e çiklizmit në shesh, dhe ne dëshiruam të ngisnim biçikletat atë ditë bashkë me ta”. Aktiviteti përfshiu mediat dhe u dha mundësi prindërve dhe qytetarëve të bashkoheshin. Prindërit na rekomanduan që në të ardhmen të përfshihen edhe klubet sportive ose shkolla e muzikës, për ta zgjeruar aktivitetin në të gjitha gjeneratat.Linku https://bujanovacke.co.rs/2024/06/21/biciklizam-je-u-modi-osnovci-organizuju-bujanovacki-krug/.

# “SI DUKET NGA DORA E PARË?” - përvoja e pjesëmarrësit si bazë për udhëzimet

Gjatë hulumtimit janë mbledhur deklarata autentike nga pjesëmarrësit në aktivitetet e përbashkëta (nxënës, mësimdhënës, prindër dhe akterë të tjerë). Këto deklarata shpesh, në mënyrë të thjeshtë, pasqyrojnë parime të ndërlikuara edukativo-pedagogjike të arsimit ndërkulturor. Përzgjedhim disa deklarata konkrete që mund të shërbejnë si pikëmbështetje për formimin e udhëzimeve më të përgjithshme. Edhe pse disa mësime përsëriten, kemi vënë theksin te kuptimet shtesë dhe kompleksiteti që aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore i japin proceseve të përgjithshme arsimore. Deklaratat e analizuara janë gjithashtu shembull i asaj që mund të mësojmë kur dëgjojmë me kujdes njëri-tjetrin – dhe dëshmi se arsimi ndërkulturor është një proces i vazhdueshëm interpretimi, rishqyrtimi dhe të mësuari.

> *“Nëse nuk ka zhurmë, nuk ka as orë të suksesshme”*
>
> - Arsimtarja

Gjatë aktiviteteve të përbashkëta të suksesshme, shpesh dëgjohet zhurmë, të qeshura, biseda të zëshme – disa lojëra dhe veprimtari gjenerojnë pikërisht atë zhurmë që tregon relaksim dhe ndërveprim të angazhuar, pra bashkëpunim ndërkulturor. Prandaj është e rëndësishme që pjesëmarrja e zhurmshme të mos interpretohet menjëherë si mungesë disipline. Udhëheqja e mirë nënkupton aftësinë për të dalluar kur zhurma është në funksion të qëllimeve edukative dhe kur është e nevojshme të krijohen kushte më të qeta për punë.

> *“U thashë prindërve që më pëlqeu shumë dhe dua të shkoj përsëri. Ata më thanë: ‘Edhe mua do më pëlqente, ashtu shkonim bashkë dikur.’”*
>
> - Nxënëse e klasave të ulëta SHF

Në përgjithësi, është vërejtur se prindërit rrallëherë kanë kohë dhe interes të mjaftueshëm për të marrë pjesë aktive në aktivitetet e planifikuara. Prandaj është e çmuar të vlerësohet dhe të mbështetet çdo shenjë që tregon se fëmijët ndajnë përshtypjet e tyre nga aktivitetet, se në familje zhvillohen biseda për përvoja pozitive ndërbrezore, dhe se përmes këtyre shkëmbimeve – edhe pse në mënyrë të tërthortë – prindërit përfshihen. Nuk duhet hequr dorë nga informimi i vazhdueshëm (mbledhje me prindër, dërgimi i fotografive) dhe nga ftesat për prezantime dhe ngjarje përmbyllëse. Prindërit vazhdimisht theksojnë se kjo ka rëndësi për ta.Gjithashtu, në deklaratën e përmendur më herët, mund të vërejmë se në historinë e bashkëjetesës ndërbrezore gjithmonë ekzistojnë shembuj pozitivë që afirmojnë vlerat ndërkulturore. Përveç se i konfirmojnë këto vlera te fëmijët, rrëfimet e prindërve mund të shërbejnë si burim për aktivitete të reja që do t’i përfshinin ata në mënyrë të drejtpërdrejtë.

> *“99% e fëmijëve serbë nuk kanë hyrë kurrë në xhami. Në fillim pati pak rezistencë, por pastaj jo. U mahnitën nga qilimi dhe madje thanë se nuk kishin ndjerë kurrë një ndjesi më të bukur – sepse qilimi ishte si një masazh i vërtetë.”*
>
> - Arsimtarja

Hyrja në një sferë ndryshe, të re dhe të panjohur mund të shkaktojë rezistencë – një reagim që duhet kuptuar dhe pranuar. Por po aq e rëndësishme është të inkurajohet dalja nga zona e rehatisë drejt zonës së zhvillimit, ku arsimi ndërkulturor ndodh në mënyrë të gjallë.Rrugët drejt kësaj përvoje janë të shumta dhe shpesh jo verbale, por multisensoriale: përmes shijes, tingullit, pamjes, aromës, prekjes, estetikës së hapësirës… Këto përvoja duhet të përdoren me vetëdije si mjete edukative.

> ***"…po, bëmë diçka… por më e bukura në orën e përbashkët ishte që ishim bashkë. Bashkë punuam, bashkë hëngrëm… Sa e mirë ishte ajo pite!" "Luajmë futboll, bëjmë ekipe të përziera dhe duhet të komunikojmë. Pastaj, pas futbollit, filloi gjithçka – festat, ditëlindjet… Sidomos ishim të bashkuar kur pastroheshin kuzhinat."***
>
> - Nxënësitë e shkollave të mesme

Zgjedhja e kujdesshme e përmbajtjes padyshim ndikon në cilësinë e aktivitetit të përbashkët, por duhet të kemi parasysh se çdo aktivitet i përbashkët (edhe ai më i thjeshti, më pak i strukturuar) nëse është i orientuar drejt një qëllimi të përbashkët, forcon ndjenjën e përkatësisë në një grup të ri.Fëmijët zakonisht afrohen përmes ushqimit të përbashkët, punëve të përbashkëta për rregullim dhe pastrim, festimeve, lojërave, sportit… Pikërisht këto momente të thjeshta krijojnë lidhje të thella dhe të qëndrueshme.

> ***"Gjuhën e basketbollit e kuptojnë të gjithë – për të gjithë driblimi është driblim, pasimi është pasim. Sepse kemi një qëllim të përbashkët – të jemi ekip!"***
>
> - Trajneri

Përvoja dhe shembujt e bashkëpunimit në sportet ekipore janë një pikënisje e mirë për zhvillimin e vlerave ndërkulturore. Është e dobishme të ofrohen aktivitete që janë të njohura, të dashura dhe të lehta për t'u organizuar. Edhe pse ekipet e përziera etnikisht janë një hap i parë i rëndësishëm, është e dëshirueshme që lojërat sportive të përshtaten më tej me arsimin ndërkulturor – përfaqësim i barabartë gjinor, zhvendosje e theksit nga konkurrenca drejt bashkëpunimit, ndryshim i rregullave në drejtim të përfshirjes maksimale, dhe fokus jo te rezultati, por te përvoja e lojës së përbashkët.

> ***"Besoj në projekte – nxjerrja e nxënësve nga arsimi klasik dhe tradicional është shumë e dëshirueshme, interesante dhe sjell cilësi shtesë, mundësi të reja. Ajo nxit zbulimin dhe shprehjen e talenteve te të rinjtë, duke i ndihmuar të njohin aftësi që nuk e dinin se i kishin. E gjithë kjo hap dyer të reja për fëmijët. Në përgjithësi, kur ndodhin aktivitete të tilla, energjia dhe entuziazmi i të gjithë aktorëve në shkollë është krejtësisht ndryshe."***
>
> - Bashkëpunëtor professional

Punëtoritë e mira ndërkulturore zhvillojnë në mënyrë holistike talentet dhe kompetencat e nxënësve dhe arsimtarëve. Atmosfera pozitive nga aktivitetet e përbashkëta ndërkulturore

reflektohet në klimën e rregullt shkollore. E gjithë bashkësia shkollore duhet të jetë mbështetëse ndaj aktiviteteve të përbashkëta – motivimi dhe disponimi i të rriturve formëson qasjen e nxënësve.

> *"Fëmijët e pranuan shumë lehtë punën në grup. Për ta nuk kishte rëndësi nëse quhesh Petra apo Adem – rëndësi kishte që tani po punonim bashkë. (...) Arsimtarët bashkëpunuan sikur njiheshin prej 100 vitesh."*
>
> - Prindi

Marrëdhëniet ndërmjet udhëheqësve të aktiviteteve janë një nga burimet më të fuqishme të ndikimit te të rinjtë. Kur të rriturit bashkëpunojnë lehtësisht, përdorin të dyja gjuhët, tregojnë interes për njëri-tjetrin, respektohen, bëjnë shaka... fëmijët marrin modele të mira për ndërtimin e marrëdhënieve të tyre. Për më tepër, trajtimi i barabartë i të gjithë pjesëmarrësve nga ana e udhëheqësve shërben si shembull i përgjithshëm i respektit të ndërsjellë.

> *"Sa më shumë të shoqërohesh me të tjerët, aq më shumë përvojë fiton – sepse çdo arsimtar ka metodat e veta dhe nga secili mund të merret diçka e mirë. Sidomos mund të merren ide të mira, të cilat me kohë shterojnë në orët e zakonshme, prandaj frymëzimi i ri është gjithmonë i mirëpritur."*
>
> - Arsimtari

Mjedisi ndërkulturor është një fushë e re për modernizimin pedagogjik të punës së çdo arsimtari – një hapësirë për shkëmbim horizontal të dijes dhe përvojave. Kjo përfaqëson edhe një mundësi për zhvillim profesional, që shpesh mungon në mënyrë sistematike.

> *„Gjatë punëtorive të përbashkëta dëgjohet e qeshura e fëmijëve dhe nuk ka dallime mes tyre."*
>
> - Arsimtarja

Atmosfera e mirë në grupet etnikisht të përziera ka rëndësi të shumëfishtë – ajo është njëkohësisht parakusht, tregues dhe rezultat i dëshiruar i aktiviteteve ndërkulturore efektive. Të qeshurat e përbashkëta tregojnë krijimin e një kuptimi të përbashkët të situatës; ato mund të zbusin pasiguritë dhe tensionet e mundshme. Relaksimi i atmosferës duhet të jetë spontan, por gjithmonë i lidhur me qëllimin dhe kontekstin e aktivitetit.

> *Ata janë shumë mirë së bashku në punëtori, por që të nisen vetë e të shkojnë për kafe... – kjo është e vështirë.Ky është qëllimi ynë i radhës."*
>
> - Koordinatori shkollor

Nuk duhet harruar se kuptimi i aktiviteteve të përbashkëta është i orientuar drejt një mënyre të plotë ndërkulturore të jetesës – përtej vetë aktiviteteve. Përvoja tregon se ky është një qëllim që nuk arrihet lehtë dhe nuk varet vetëm nga proceset arsimore. Për bashkëjetesën ndërkulturore nevojitet punë e qëndrueshme, shumëvjeçare, besim në proceset e nisura, si dhe mbështetje shoqërore-politike nga aktorë të ndryshëm dhe nga e gjithë bashkësia.

# LISTA E KONTROLLIT për përgatitjen, realizimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të përbashkëta

Pavarësisht nëse planifikoni një shkëmbim ndërkulturor, një aksion publik apo një orë të përbashkët, është gjithmonë e dobishme të mendoni paraprakisht, gjatë dhe pas aktivitetit për disa çështje. Tabelat e mëposhtme janë krijuar në mënyrë që të mund t'i kopjoni dhe t'i përdorni sa herë që ju nevojiten.

## 1. Përgatitja e aktivitetit

| | Po / Jo / Nuk aplikohet | Koment | Sugjerime |
|---|---|---|---|
| Janë përcaktuar objektivat ndërkulturorë të aktivitetit | | | Objektivat duhet të jenë realistë dhe të lidhur me programin shkollor (mundësi për zhvillimin e kompetencave ndërdisiplinore). |
| Aktiviteti është dakorduar me kolegët | | | Aktiviteti duhet të jetë i harmonizuar me planin dhe programin e shkollës dhe i njohur për komunitetin e shkollës. Do të ishte mirë nëse njëri nga mësuesit do të merrte përsipër rolin e të ashtuquajturit koordinator i shkollës - ndërmjetës midis nxënësve, prindërve, mësuesve dhe drejtorisë së shkollës. |
| Janë zgjedhur metoda(t) e përshtatshme të punës | | | Metodat dhe format e punës duhet të jenë të përshtatshme për moshën dhe dinamikën e grupit – për fëmijët e ciklit të ulët të shkollës fillore sa më shumë lojëra dhe komunikim joverbal; më pak përkthim. |
| Janë përgatitur materialet dhe pajisjet teknike | | | Materialet duhet të jenë nxitëse – të larmishme, shumëfunksionale. Zakonisht mjaftojnë markerë, ngjyra dhe letra të ngjyrosura. Pajisjet teknike duhet të kontrollohen para realizimit të aktivitetit. Hapësira duhet të mundësojë aktivitete interaktive në grup. |
| Materialet dhe mjetet janë të përshtatura për kontekstin shumëgjuhësh dhe ndërkulturor | | | Materialet, udhëzimet dhe shembujt duhet të jenë të përgatitur në të dyja gjuhët, duke respektuar kontekstin kulturor. Detyrat duhet të përshtaten me aftësitë gjuhësore, njohuritë paraprake dhe ritmin e grupit; të planifikohen aktivitete shtesë për mbështetje të nxënësve që kanë nevojë për ndihmë ose tejkalojnë objektivat e përcaktuara. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Hapësira dhe koha janë harmonizuar me drejtimin e shkollës** | | | Rezervoni hapësirën me kohë të mjaftueshme; veçanërisht tregoni kujdes për organizimin e transportit për fëmijët nga zonat rurale, caktoni me kohë transportin me taksi. |
| **Nxënësit janë informuar / përfshirë në përgatitjen e aktivitetit** | | | Qasja nxitëse dhe motivuese e personit që informon për aktivitetin e ardhshëm ndikon në motivimin e pjesëmarrësve. Informacioni për aktivitetin e planifikuar duhet të jetë i qartë, ndërsa emërtimet e aktiviteteve në agjendë të jenë tërheqëse dhe të afërta me interesat dhe fjalorin e nxënësve. Në varësi të dinamikës së aktivitetit, nxënësit duhet të përfshihen si në konceptim ashtu edhe në përgatitjen e aktivitetit të përbashkët. |
| **Prindërit janë informuar / përfshirë** | | | Interesi më i zakonshëm i prindërve lidhet me sigurinë e fëmijëve: që kanë arritur në aktivitet, që janë pjesëmarrës dhe që janë nisur me transport. Ekzistenca e një grupi në Viber njihet si lehtësim i rëndësishëm në këtë drejtim. Për të zgjeruar fushën e pjesëmarrjes së tyre, është e nevojshme të vazhdohet me këmbëngulje dhe durim me ftesa, informime, kërkesa për reagime, mendime dhe sugjerime – të gjitha në funksion të pjesëmarrjes sa më aktive të tyre. Prindërit pëlqejnë fotografitë e fëmijëve të tyre gjatë aktiviteteve, ndaj kjo duhet të praktikohet vazhdimisht. Në përputhje me aktivitetin e konceptuar, prindërit mund të përfshihen si pjesëmarrës të barabartë ose si mbështetës. |
| **Është përgatitur plani i aktivitetit (rrjedha kohore, rolet)** | | | Një plan i mirë përfshin një strukturë të menduar dhe kohëzgjatje të planifikuar për çdo nënaktivitet, por gjithashtu lejon fleksibilitet gjatë realizimit (p.sh. rishpërndarje kohe nëse vlerësohet se duhet të futet një lojë për energjizimin e grupit, lënia e kohës për pyetje të pritshme dhe/ose devijime të paparashikuara nga tema etj.). Optimalisht, pushimi për ushqim duhet të zgjasë gjysmë ore në rastet e aktiviteteve më të gjata. Duhet planifikuar koha për organizimin e hapësirës (vendosja e karrigeve, postera…). Të parashikohet kush udhëheq cilin aktivitet dhe si do të zhvillohet dinamika e përkthimit. |
| **Janë shqyrtuar sfidat e mundshme dhe zgjidhjet alternative** | | | Të mendohet paraprakisht për pikat e mundshme të ngecjes dhe të përgatiten zgjidhje situative të përafërta. Të mbështetemi në përvojën e fëmijëve dhe miqësinë e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme. |

## 2. Rrjedha e aktiviteteve

| | Po / Jo / Nuk aplikohet | Koment | Sugjerime |
|---|---|---|---|
| Aktivitet për energjizim dhe njohje | | | Aktivitetet hyrëse ndikojnë në rrjedhën e mëtejshme të programit, japin "tonin" fillestar dhe kontribuojnë në krijimin e një atmosfere të përshtatshme. Është e dëshirueshme njohja e frazave bazë në të gjitha gjuhët e pjesëmarrësve. Lojërat për njohje, lidhje dhe memorizim emrash janë të mirëpritura në fillim. Disa emra të huaj mund të jenë të vështirë për t'u shqiptuar apo mbajtur mend – mos u shqetësoni për gabimet; e rëndësishme është përpjekja për të respektuar emrin e secilit si pjesë thelbësore e identitetit të tij/saj personal. |
| Janë vendosur rregullat e punës dhe organizimit | | | Menjëherë pas lojës hyrëse për njohje dhe çlodhje, është e rëndësishme të vendosen rregullat. Ato mund të dalin nga një bisedë e përbashkët mbi pritshmëritë ose në mënyra të tjera, por gjithmonë përmes dialogut dhe shpjegimit të qëllimit të tyre. Nëse është takimi i parë, është në rregull që udhëheqësit të propozojnë rregullat, ndërsa në rastin e punëtorive shumëditore apo ekskursioneve, mund të ofrohet mundësia që nxënësit t'i shtojnë apo rishikojnë ato. Është shumë e dobishme që rregullat të paraqiten në mënyrë vizuale dhe të vendosen në një vend të dukshëm në hapësirën e punës. |
| Të gjithë nxënësit kanë mundësi për pjesëmarrje | | | Përmes mënyrës së udhëheqjes, krijohen kushte për përfshirje të barabartë të të gjithëve; me një qasje të matur, pa imponim, inkurajohet pjesëmarrja duke ofruar kohë të mjaftueshme dhe forma të ndryshme shprehjeje (me aktrim, gjest, tingull); puna në grupe të vogla shpesh ndihmon fëmijët të aktivizohen (mund të nxitet më tej përmes ndarjes dhe ndryshimit të roleve – kush raporton, tregon, shkruan). Dëgjimi aktiv i të gjithë anëtarëve është parakusht që çdo nxënës të ndihet i përfshirë. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Atmosfera është nxitëse dhe e sigurt** | | | Është mirë që në fillim të bien dakord (dhe të shkruhen) rregullat e përbashkëta të punës që sigurojnë siguri, respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Pjesëmarrësit janë më të motivuar për të marrë pjesë dhe për të mësuar kur ndihen të sigurt dhe të pranuar. Nëse është e nevojshme, kujtojini nxënësit për rregullat e dakorduara. |
| **Koha përdoret në mënyrë të qëllimshme** | | | Kohëzgjatja duhet gjithmonë t'i përshtatet grupit; nuk duhet të nxitohet aktiviteti "vetëm për hir të agjendës", të përshpejtohet diskutimi funksional apo të ndërpriten situatat spontane që lindin si shprehje e humorit të përshtatshëm (të lihet kohë që nxënësit të qeshin dhe të rikthehen në fokusin kryesor të aktivitetit). Është e rëndësishme të jemi fleksibël ndaj pyetjeve të papritura apo drejtimit të diskutimit, nëse ato janë në funksion të objektivave ndërkulturorë. |
| **Ka kohë të mjaftueshme për përmbledhjen e aktivitetit** | | | Aktivitetet përmbyllëse ndihmojnë në kuptimin e përvojave të përjetuara, lidhjen/krahasimin me përvojat e mëparshme dhe nxjerrjen e njohurive të reja. Gjatë përmbledhjes, udhëheqësi duhet të përfshijë të gjithë procesin e kaluar dhe në mënyrë të natyrshme të theksojë dhe afirmojë mendimet dhe qëndrimet (ndërkulturore) të vlefshme që janë dëgjuar në grup, duke i rikthyer ato pjesëmarrësve si një paketë përvoje të përbashkët të fituar |



## 3. Vlerësimi dhe reflektim

| | Po / Jo / Nuk aplikohet | Koment | Sugjerime |
|---|---|---|---|
| Nxënësit japin reagim (feedback) | | | Ka mënyra të ndryshme për dhënien e reagimit (ngjitja e stikerrave me momentet e preferuara; shkalla e ndjenjës; një fjalë; vlerësime brenda grupeve të vogla dhe ndarja në grupin e madh...). Nxënësit mund të vlerësojnë sa mundësi kanë pasur të gjithë për të marrë pjesë dhe/ose sa të përfshirë e të respektuar janë ndjerë. Përveç reagimit për aktivitetin e realizuar, është e rëndësishme që nxënësit të pyeten për të propozuar temën, mënyrën e punës apo aktivitetin për takimin e ardhshëm të përbashkët ku do të dëshironin të merrnin pjesë. |
| Arsimtarët kanë shkëmbyer përshtypje, emocione dhe sugjerime | | | Shpesh harrohet shkëmbimi i përshtypjeve mes udhëheqësve të aktivitetit. Është e rëndësishme të ndalemi te ato që kanë funksionuar mirë dhe të shkëmbehen lëvdata, me hapje për të dhënë sugjerime për atë që mund të përmirësohet dhe të jetë më funksionale |
| Aktiviteti është dokumentuar (foto, tekst, punime) | | | Leja për fotografim dhe dokumentim të aktivitetit duhet të merret paraprakisht, me pëlqimin e nxënësve dhe prindërve. Aktivitetet mund të dokumentohen në formate të ndryshme, duke përfshirë fotografi, video, postera, punime të shkruara, vizatime apo regjistrime audio. Materialet e dokumentuara duhet të sistematizohen dhe të ruhen me respekt për privatësinë dhe udhëzimet etike, duke ruajtur vlerat ndërkulturore. Mund të përdoren për vlerësim, planifikim të aktiviteteve të ardhshme, si dhe për promovimin e shembujve të praktikave të mira. |
| Janë identifikuar aspektet që mund të përmirësohen | | | Në një mjedis ndërkulturor ndodhin situata që mund të na befasojnë. Është e dëshirueshme të reflektohet se cilat bindje kanë çuar në një reagim potencialisht të papërshtatshëm, nga vjen ajo bindje dhe çfarë roli ka në kontekstin ndërkulturor. |
| Është shqyrtuar plani për hapin/ aktivitetin e ardhshëm | | | Përshtypjet e freskëta pas përfundimit të aktivitetit janë udhërrëfyesi më i mirë për konceptimin e aktiviteteve të ardhshme. Praktikë e mirë është të shkruhen, për shembull, tre gjëra të rëndësishme që nuk duhet harruar herën tjetër. |

# "Çfarë është ora e përbashkët?" – udhëzime edukativo-pedagogjike për aktivitetin (shembull i orës së përbashkët)

Ora e përbashkët është një orë mësimore dygjuhëshe që realizohet nga dy ose më shumë arsimtar përmes përgatitjes dhe zbatimit të përbashkët të aktivitetit me një grup nxënësish të përzier etnikisht. Kjo orë nënkupton:

- **Përgatitje të përbashkët:** Marrëveshje për temën, objektivat, detyrat dhe rolin e secilit arsimtarë, me fokus te vlerat dhe objektivat ndërkulturorë.
- **Organizimin e orës:** Përshtatjen e përmbajtjes dhe dinamikës sipas moshës së nxënësve, zgjedhjen e vendit dhe përgatitjen e nxënësve (dhe prindërve, nëse është e nevojshme) për të marrë pjesë në aktivitetin e përbashkët.
- **Realizimin e orës:** Aktivitetet janë të dizajnuara për të nxitur bashkëpunimin, kohezionin dhe atmosferën pozitive mes nxënësve, duke integruar vlerat ndërkulturore krahas rezultateve të zakonshme arsimore.
- **Mundësinë për modelim dhe shpërndarje të praktikave të mira:** Ora mund të shërbejë si shembull për arsimtarë dhe shkolla të tjera, duke përfshirë edhe aktorë nga komuniteti lokal

**Ora e përbashkët nuk është vetëm një aktivitet formal mësimor, por një mjet për zhvillimin e kompetencave ndërkulturore të nxënësve dhe arsimtarëve përmes bashkëpunimit, respektimit të dallimeve dhe të mësuarit të përbashkët. Besojmë se mund të realizohet edhe me më shumë se dy gjuhë – provoni dhe na tregoni përshtypjet tuaja**

Ora e përbashkët nuk i anashkalon objektivat edukativo-arsimorë, por u qaset atyre në një mënyrë tjetër: përmes takimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit ndërkulturor. Prandaj, formatet për ndjekje janë të dobishme, por duhet të interpretohen në mënyrë fleksibile, në përputhje me veçantitë e kësaj ore, ku vlera e marrëdhënieve, emocioneve dhe bashkëpunimit është po aq e rëndësishme sa edhe përvetësimi i përmbajtjes. Në fund të këtij udhëzuesi gjendet një fletë ndjekjeje si mbështetje për punën. Më poshtë është një përmbledhje e karakteristikave që drejtojnë potencialin edukativo-arsimor të orës së përbashkët, bazuar në përvojën e arsimtarëve, nxënësve dhe akterëve të tjerë. Kur bëhet fjalë për orën e përbashkët (shembull):

- Më e rëndësishme është që nxënësit të punojnë së bashku, sesa individualisht.
- Më e rëndësishme është që grupet të jenë të përziera, sesa të formohen sipas aftësive, vendit të uljes apo njohjeve personale. Rekomandohet përzgjedhje e rastësishme (p.sh. nxjerrja e kartelës, ngjyrës, numrit) ose formimi i grupeve të përziera sipas ndonjë karakteristike të përbashkët (p.sh. sporti i preferuar, ngjyra, stina, ushqimi).
- Më e rëndësishme është që nxënësit të zhvillojnë emocione pozitive ndaj punës së përbashkët, sesa të përvetësojnë të gjithë lëndën e parashikuar.
- Theksi vihet te zbulimi i së resë nga ana e nxënësve, jo te demonstrimi i asaj që tashmë e dinë.
- Prioritet i jepet çdo forme bashkëpunimi mes nxënësve, jo zbatimit të saktë të detyrës apo korrektësisë së çdo fjale.
- Është e dëshirueshme që në punë të jetë i pranishëm humori, pasi ai ndikon në çlodhje dhe nxitje.
- Përparësi ka bashkëpunimi dhe kënaqësia e çiftit të arsimtarëve gjatë mësimdhënies, krahasuar me pjesë të ndara të orës të realizuara në mënyrë të përsosur.
- Theksohet rëndësia që nxënësit të jenë të përfshirë aktivisht, të inkurajohen të bëjnë pyetje dhe të ndihen të stimuluar, më shumë sesa të synohet vetëm "përgjigjja e saktë".
- Është e dëshirueshme që rrjedha e orës të përshtatet spontanisht me nevojat dhe dinamikën e grupit, në frymën e nxitjes së vlerave ndërkulturore, në vend që të ndiqet rreptësisht një plan i përgatitur paraprakisht.

## Rekomandime për përgatitjen e suksesshme të orës së përbashkët

1. Në të gjitha materialet dhe shembujt gjatë orës duhet të jetë e dukshme se të gjitha gjuhët kanë vendin e tyre. Përfshini mbishkrime, fjalë dhe detyra në disa gjuhë. Përdorni "bashkësinë si fushë mësimi" – p.sh. "Si përshëndetemi?" në gjuhë të ndryshme – jo si përkthim, por si pjesë e krijimit të një atmosfere të mirë përmes lojërave të vogla gjuhësore. Kartela me fraza: në secilën kartelë shkruhet një frazë në një gjuhë. Nxënësit duhet të gjejnë të tjerët që kanë kartela me të njëjtin kuptim ose të formojnë një fjali duke përdorur disa gjuhë.Dialogë të shpërndarë: nxënësit marrin detyrë të shkruajnë në gjuhën e tyre një përshëndetje ose një frazë të shkurtër që përshkruan një aktivitet grupor. Më pas, nxënësit e tjerë përpiqen të kuptojnë kuptimin përmes kontekstit ose gjesteve.

2. Është e rëndësishme të vendosen struktura që u japin të gjithë nxënësve mundësinë të flasin – pa presion, me mundësi për shprehje joverbale (vizatim, gjest, simbol).Shembuj: "Rrethi i vogël i prezantimit" (emër / cilësi që fillon me shkronjën e parë të emrit tënd), "Guri i miqësisë" (një objekt që përdoret gjatë aktivitetit për të simbolizuar miqësinë dhe kontributin e përbashkët të grupit – çdo nxënës mund ta mbajë ndërsa shpreh një mendim ose kompliment për të tjerët), "Trego çfarë të pëlqen përmes lëvizjes".

3. Qëllimi nuk është që të gjithë të "mësojnë të njëjtën gjë", por që të gjithë të ndihen të përfshirë dhe të kenë mundësi të kontribuojnë. Prandaj, suksesi nuk matet vetëm përmes detyrës, por edhe përmes asaj se sa nxënësi e ka parë veten në temë, sa i lirë ka qenë të ndajë diçka me të tjerët dhe nëse ka zgjeruar këndvështrimin e tij për tjetrin.

4. Roli i çiftit të arsimtarëve nuk është vetëm të "ndajnë detyrat", por të modelojnë bashkëpunimin, respektin e ndërsjellë dhe kureshtjen. Këto janë vlera që nxënësit i përthithin në mënyrë të pavetëdijshme.

5. Cilësia e orës së përbashkët matet edhe me atë se sa të sigurt, mirë dhe të motivuar janë ndier nxënësit për të folur, bashkëpunuar dhe mësuar nga njëri-tjetri.

# Përshtatja e indikatorëve të suksesit të orës së përbashkët

Është vërtetuar se modeli standard për vëzhgimin dhe vlerësimin e orës mësimore paraqet një pikënisje të mirë për shqyrtimin e cilësisë së orëve të përbashkëta. Megjithatë, një orë që përfshin nxënës nga grupe të ndryshme etnike, gjuhësore apo kulturore, me qëllim zhvillimin e kompetencave ndërkulturore, bën që disa elementë të marrin rëndësi të veçantë. Përvoja e arsimtarëve tregon qartë se indikatorët standardë për ndjekjen dhe vlerësimin e orës nuk janë gjithmonë të zbatueshëm në kontekstin e orës së përbashkët, dhe se ata kanë nevojë për plotësim. Edhe pse disa indikatorë nga modeli standard janë të vlefshëm edhe për orën ndërkulturore të përbashkët, tabela e mëposhtme paraqet një shembull të përshtatjes së indikatorëve standardë me objektivat arsimore ndërkulturore.

| Arsimtarët menaxhojnë në mënyrë efikase procesin e të nxënit gjatë orës | Mësimdhënësit menaxhojnë në mënyrë efikase procesin e të nxënit ndërkulturor gjatë orës së përbashkët |
|---|---|
| Nxënësit i kanë të qarta objektivat e orës / rezultatet e të nxënit dhe kuptojnë pse duhet të mësojnë atë që është planifikuar | Të gjithë nxënësit, pavarësisht përkatësisë etnike, i kanë të qarta objektivat e orës / rezultatet e të nxënit dhe kuptojnë pse është organizuar ora e përbashkët. Nxënësit e dinë se një nga objektivat është bashkëpunimi me bashkëmoshatarët nga shkolla tjetër. |

| | |
|---|---|
| Nxënësi kupton shpjegimet, udhëzimet dhe konceptet kyçe. | Të gjithë nxënësit kuptojnë shpjegimet, udhëzimet dhe konceptet kyçe. |
| Arsimtariorganizojnë orën duke përdorur metoda të përshtatura për të nxënë mbi kulturën tjetër, duke u përshtatur me dinamikën e grupit. strukturon dhe lidh pjesët e orës duke përdorur metoda të ndryshme (forma pune, teknika, procedura...). | Arsimtarët organizojnë orën duke përdorur metoda të përshtatura për të nxënë mbi kulturën tjetër, duke u përshtatur me dinamikën e grupit. |
| Arsimtari vendos gradualisht pyetje / detyra / kërkesa me nivele të ndryshme kompleksiteti. | Arsimtarët vendosin pyetje që ftojnë përfshirjen e nxënësve nga të dy kulturat. |
| Arsimtari drejton ndërveprimin mes nxënësve në funksion të të nxënit (përdor pyetje, ide, komente të nxënësve, nxit të nxënit mes bashkëmoshatarëve). | Arsimtari drejton ndërveprimet në mënyrë që të nxisë bashkëpunimin në grupe të përziera. |
| Arsimtari përdor në mënyrë funksionale mjetet mësimore ekzistuese dhe burimet e njohurive të disponueshme për nxënësit. | Arsimtarët përmes bashkëpunimit të ndërsjellë, u tregojnë nxënësve si duket bashkëpunimi ndërkulturor. |

Është e qartë se disa indikatorë kanë mbetur të pandryshuar, ndërsa në disa raste ka pasur ndryshime më të vogla ose më të mëdha. Një ushtrim i dobishëm për arsimtarët është gjithmonë të shtrojnë pyetjen: çfarë është e përbashkët për një orë cilësore të rregullt dhe një orë të përbashkët, dhe më pas: cilat cilësi të veçanta duhet të ketë një orë e përbashkët. Indikatorët që arsimtarët i kanë veçuar si më të rëndësishmit për orën e përbashkët mund t'i gjeni në shtojcën në vijim, ku është ofruar një formular vlerësimi për orën e përbashkët. Qëllimi i këtij formulari është të mbështesë arsimtarët në identifikimin dhe forcimin e vlerave ndërkulturore, sigurisë emocionale dhe cilësisë së takimit, si rezultate edukativo-arsimore po aq të rëndësishme sa edhe përvetësimi i përmbajtjes mësimore.Qëllimi ynë është që ky formular të shërbejë si udhërrëfyes dhe kujtesë për cilësinë e takimit – jo si një detyrë shtesë, por si mbështetje për arsimtarët në planifikim dhe reflektim. Për më tepër, është përgatitur edhe një formular i shkurtër për vetëvlerësimin e çiftit të arsimtarëve – si një kujtesë në momentet e pasigurisë.



# Formulari përcjellës për ndjekjen e orës së përbashkët në kontekst ndërkulturor

## FORMULAR PËR VËZHGIMIN DHE VLERËSIMIN E ORËS SË PËRBASHKËT

| | | |
|---|---|---|
| **Lënda dhe klasa:**<br>**Njësia mësimore:** | **Data:** | **Çifti i arsimtarëve:** |
| Informata kthyese: | | |

[1] *Formulari përcjellës për ndjekjen e orës së përbashkët është i bazuar në parimet e: teorisë së ndjeshmërisë ndërkulturore, pedagogjisë së përkatësisë, mësimit pjesëmarrës, të drejtave të fëmijës dhe arsimit demokratik*
.

| | **Vlerësimi**<br>**1 2 3 4** | **Çfarë ishte e mire/ pozitive?Sugjerime për përmirësim** |
|---|---|---|
| Nxënësit e dinë që qëllimi është të bashkëpunojnë me bashkëmoshatarë nga shkolla/kultura tjetër. | | |
| Në hyrje të orës përmendet rëndësia e bashkësisë, mirëkuptimit dhe hapjes. | | |
| Arsimtarët kanë parashikuar momente gjatë orës për aktivitete “thyerje akulli” që ndihmojnë nxënësit të njohin më mirë bashkëmoshatarët nga shkolla apo grupi kulturor tjetër. | | |
| Nxënësit kanë marrë pjesë aktive në aktivitetin “thyerje akulli”. | | |

| | | |
|---|---|---|
| Puna në grup është strukturuar në mënyrë që nxënësit të komunikojnë mes vete dhe të marrin vendime së bashku. | | |
| Detyrat kanë kërkuar që nxënësit të njohin tjetrin, të pyesin, të shpjegojnë. | | |
| Në ushtrime janë përdorur fjalë, simbole, këngë, ilustrime nga gjuhë apo kultura të ndryshme. | | |
| Arsimtarët kanë udhëhequr orën në mënyrë të barabartë, janë ndërruar dhe kanë plotësuar njëri-tjetrin. | | |
| Pjesëmarrësit janë respektuar pavarësisht gjuhës që flasin (me përkthim të ndërsjellë, përkthim në anglisht, komunikim joverbal). | | |
| Arsimtarët kanë vërejtur kur ndërveprimet brenda grupit kanë qenë intensive dhe kanë përshtatur detyrën/tempon. | | |
| Është dëgjuar e qeshura, ka pasur shaka dhe shkëmbime joformale mes nxënësve nga komunitete të ndryshme kulturore. | | |
| Nxënësit që ndihen të pasigurt marrin mbështetje të qartë në momentin kur u nevojitet. | | |
| Nxënësit nga të dy grupet gjuhësore/etnike marrin pjesë në mënyrë të barabartë në aktivitete dhe diskutime. | | |
| Arsimtari e njeh dhe ndërhyn kur paraqitet ndonjë stereotip apo pabarazi në orë, duke e kthyer situatën në mundësi për të mësuar mbi respektin dhe dallimet. | | |
| Në fund janë bërë pyetje të tipit: "Çfarë ju habiti sot?", "Çfarë ju pëlqeu?", "Çfarë do të merrnit me vete nga kjo përvojë?" | | |

# Përkujtues i shkurtër për vetëvlerësimin e orës së përbashkët nga çifti mësimdhënës

| Aspekti interkulturor | Pyetje kyçe | Çfarë të vëzhgojë | ✓ Nëse është vërejtur |
|---|---|---|---|
| 1. Qëllimi dhe kuptimi i përbashkët | A është e qartë pse nxënësit janë bashkë? | Sqarim hyrës mbi vlerën e takimit, qëllime që përfshijnë bashkëpunim dhe shkëmbim | ☐ |
| 2. Grupet e përziera dhe bashkëpunimi | A bashkëpunojnë nxënësit në kombinime të ndryshme? | Grupe të përziera sipas gjuhës/ origjinës, punë ekipore, ndihmë e ndërsjellë | ☐ |
| 3. Dukshmëria e dallimeve | A janë të pranishme gjuhë, tregime, simbole të ndryshme? | Ndërveprim aktiv në grupe, shprehje interesi dhe kureshtjeje | ☐ |
| 4. Cilësia e kontaktit | A komunikojnë nxënësit, bëjnë pyetje, shkëmbejnë? | Ndërveprim aktiv në grupe, shprehje interesi dhe kureshtjeje | ☐ |
| 5. Atmosfera e takimit | A ka ngrohtësi, qetësi dhe humor? | Të qeshura, besim, shkëmbim joformal, pranimi i gabimeve | ☐ |
| 6. Barazia mes arsimtarëve | A e udhëheqin bashkë orën çifti dygjuhësh i arsimtarëve? | Plotësim i ndërsjellë, përkthim, modelim i bashkëpunimit | ☐ |
| 7. Fleksibiliteti dhe reagimi ndaj grupit | A përshtatet ora me nevojat e grupit? | Ndryshim i tempos, pyetje shtesë, reagim ndaj ngecjeve | ☐ |
| 8. Reflektimdhe kuptim | A patën nxënësit mundësi të shprehin përjetimin e tyre? | Rreth përmbyllës, përshtypje, vizatim, shkrim, fjalia: “M’u duk bukur kur...” | ☐ |

- Çfarë ishte e çmuar në këtë takim?(p.sh. momenti i mirëkuptimit, bashkëpunim i papritur, nxënës që u përfshi për herë të parë në mënyrë aktive)
- Çfarë do të dëshironim të ruanim për orën e ardhshme të përbashkët?
- A ka hapësirë për më shumë pjesëmarrje, shkëmbim, kreativitet?
- Si mund të ishim përgatitur më mirë?

## Hapat për vlerësim përmes shkëmbimit horizontal

Një praktikë jashtëzakonisht e dobishme për përmirësimin e orëve të përbashkëta është që arsimtarët që kanë vëzhguar orën të japin informacion të kthyes konstruktiv për arsimtarët që e kanë realizuar atë. Kjo bëhet duke përdorur formularin e vëzhgimit të orës dhe treguesit shtesë të rëndësishëm për aspektet ndërkulturore.Gjatë vëzhgimit, mund të kombinohen formulari standard dhe formulari i përshtatur për orët e përbashkëta. Ky lloj shkëmbimi horizontal është vlerësuar nga shumë arsimtarë si veçanërisht i rëndësishëm.

## Hapat për dhënien e informacionit të kthyes konstruktiv

1. Prezantimi ngaarsimtarët që kanë realizuar orën paraqesin idenë bazë të orës. Japin vlerësimin e tyre për rrjedhën dhe cilësinë e orës, duke u mbështetur në përkujtuesin e shkurtër për vetëvlerësim.Në fund, mund të ndajnë çfarë do të kishin bërë ndryshe.

2. Kolegët që kanë vëzhguar orën japin informacion të kthyes konstruktiv. Njëri prej tyre paraqet komentin e harmonizuar në emër të ekipit, duke përdorur gjuhën e standardeve dhe treguesve, si dhe duke përmendur shembuj konkretë dhe arsyetime të qarta.

3. Arsimtarët që kanë realizuar orën japin një koment të shkurtër lidhur me informatën kthyese të marrë – nëse pajtohen apo jo dhe paraqesin perspektivën e tyre.

4. Pason biseda për orën dhe shkëmbimi i përvojave

# Pyetje të mundshme për vlerësimin e orës së përbashkët

1. Në çfarë mase qëllimet e orës përfshinin njohjen ndërkulturore, lidhjen emocionale dhe shkëmbimin?

2. Sa e qartë ishte për nxënësit pse ishin bashkë dhe cila ishte vlera e këtij takimi?

3. A kanë punuar nxënësit në grupe të përziera?

4. Sa mundësi patën nxënësit të bashkëpunojnë dhe të mbështeten tek njëri-tjetri?

5. Sa dhe në ç'mënyrë patën nxënësit mundësi të shprehin veten, prejardhjen, gjuhën dhe mendimin e tyre?

6. Sa të relaksuar, të përfshirë dhe të buzëqeshur ishin nxënësit gjatë kontaktit me bashkëmoshatarët e rinj?

7. Sa hapësirë patën për humor, lojë, sinqeritet – si mënyrë për t'u lidhur me të tjerët?

8. A patën nxënësit mundësi që në fund të reflektojnë dhe të ndajnë çfarë mësuan për të tjerët dhe për veten?

9. A pati kohë për një fjali/reflektim, përshtypje, vizatim apo shprehje emocionale?

10. Si u soll nxënësi në grup?(p.sh. tregoi mirëkuptim, ofroi mbështetje, bëri një pyetje të re)

11. Çfarë tha nxënësi se ishte me rëndësi për të?(përjetim emocional dhe personal)

12. Sa dhe në ç'mënyrë shfaqi nxënësi kureshtje ndaj diçkaje të re?

13. A u krijua një hapësirë ku çdo nxënës mund të flasë dhe të marrë pjesë pa rrezik për t'u tallur, etiketuar apo përjashtuar?

14. A e njeh dhe reagon arsimtari në kohë ndaj stereotipeve, pabarazisë në të folur apo qasjes së pabarabartë ndaj burimeve?

15. A kanë menduar arsimtarët paraprakisht se çfarë do të donin nxënësit të dinin për njëri-tjetrin?

16. A janë përgatitur pyetje apo aktivitete që nxisin shkëmbimin e informacionit mbi interesat, kulturën, gjuhën apo përvojat?

# GJITHÇKA QË NUK U PËRFSHI NË TABELA, POR E KEMI MËSUAR NGA PËRVOJA JONË DERI TANI

### Gjatë përzgjedhjes së pjesëmarrësve, është treguar e rëndësishme:

- përzgjedhja e fëmijëve të bazohet në dëshirën dhe motivimin e tyre për aktivitete konkrete.
- të formohen grupe të vogla – rreth 10 fëmijë nga secila shkollë, për të mundësuar kontakt më të afërt dhe cilësor.
- të ndryshohen pjesëmarrësit në aktivitete të përbashkëta – që sa më shumë fëmijë të kenë mundësi të marrin pjesë.
- të jetë procesi sa më gjithëpërfshirës – duke shmangur përzgjedhjen elitare apo të njëjtëve fëmijë çdo herë.uključivati učenike sa smetnjama u razvoju, sa lošijim ocenama, nestašnijeg ponašanja;
- të përfshihen fëmijë me vështirësi në zhvillim, me nota më të dobëta, me sjellje më të gjallë – për të promovuar barazi dhe përkatësi.
- t'u shpjegohen fëmijëve të interesuar kriteret dhe kufizimet e përzgjedhjes – për të ruajtur transparencën dhe mirëkuptimin.
- të konsultohen vetë nxënësit për përzgjedhjen – sepse ata shpesh japin sugjerimet më të mençura dhe të ndjeshme.

**Motivimi i mësimdhënësve që realizojnë aktivitete të përbashkëta ndikohet** fuqishëm nga ndjenja e mbështetjes nga komuniteti shkollor. Kjo nënkupton përkrahjen e drejtorëve të shkollave, shërbimeve psikologjike-pedagogjike dhe kolegëve të tjerë; si dhe të prindërve e komunitetit më të gjerë. Mbështetja mund të përfshijë: letra falënderimi, trajnime profesionale, njohje publike, lirimin e mësimdhënësve nga disa orë mësimore apo detyra të rregullta. Mësimdhënësit që planifikojnë dhe realizojnë orë të përbashkëta apo aktivitete jashtëmësimore duhet të kenë hapësirë kohore dhe mbështetje të qëndrueshme, në mënyrë që të shmanget lodhja dhe djegia profesionale. Ky qasje ndihmon në ruajtjen e entuziazmit dhe motivimit të mësimdhënësve më aktivë, të cilët shpesh janë nxitësit kryesorë të ndryshimeve pozitive në shkolla.

### Cilësitë e një dysheje të mirë mësimdhënësish për orë të përbashkëta:

- të paktën njëri nga mësimdhënësit të flasë të dyja gjuhët
- të dy mësimdhënësit ta duan punën në ekip
- të jenë të hapur dhe me mendje gjerë
- të plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive
- të jenë të gatshëm edhe për improvizim
- të jenë të besueshëm, kolegialë dhe të hapur në komunikimin ndërmjet tyre
- të tregojnë fleksibilitet dhe gatishmëri për mirëkuptim të ndërsjellë
- të tregojnë respekt dhe vlerësim të ndërsjellë, pa egoizëm apo rivalitet
- të nxisin njëri-tjetrin dhe të zhvillohen së bashku
- të pranojnë të gjitha aktivitetet si të përbashkëta
- të jenë të hapur ndaj komenteve dhe reflektimeve pas orës së realizuar
- të festojnë angazhimin e tyre të përbashkët, sepse dalin jashtë kornizës shkollore dhe kontribuojnë në kultivimin e vlerave ndërkulturore në shkollë/komunitet përmes shembullit të tyre personal

**Propozime për zhvillimin e Modelit:** Të lidhen nxënësit sipas interesave të tyre, e jo në bazë të shkollës që ndjekin grupet e përziera të formohen në mënyrë më spontane, pa përcaktuar kuota të rrepta për secilën shkollë.Kjo mund të realizohet përmes krijimit të seksioneve/interesgrupeve në nivel komune, ku nxënësit me interesa të përbashkëta do të grupoheshin në ekipe të përziera etnike, të pavarura nga përkatësia shkollore.Në këtë mënyrë, nxënësit do të kishin mundësi të njiheshin me bashkëmoshatarë nga shkolla të ndryshme dhe do të ndiheshin më të motivuar për të marrë pjesë.Nëse vazhdohet me modelin ekzistues të organizimit të aktiviteteve të përbashkëta (shkolla partnere të përzgjedhura sipas afërsisë gjeografike), rekomandohet që aktivitetet ndërmjet shkollave që bashkëpunojnë të organizohen më shpesh kjo do të mundësonte njohjen e mësimdhënësve dhe nxënësve të rinj, shkëmbimin e ideve të reja dhe realizimin e aktiviteteve të reja të përbashkëta.

**Është e ndershme të pranohet se:** pavarësisht përgatitjes profesionale dhe njohurive të mësimdhënësve për aktivitete të përbashkëta, si dhe motivimit të lartë dhe hapjes së pjesëmarrësve, ndonjëherë ndodhin konflikte mes tyre. Kjo është veçanërisht e pritshme gjatë aktiviteteve shumëditore apo shumëjavore, siç janë shkëmbimet ndërkulturore. Dilemat rreth përkatësisë grupore janë tipike për zhvillimin e adoleshentëve, të cilët në këtë periudhë përjetojnë emocione intensive, reagojnë fuqishëm ndaj komenteve që nuk u pëlqejnë dhe shpesh mendojnë në mënyrë të polarizuar (bardhë–zi). Këto karakteristika mund të rrisin gjasat për konflikt gjatë aktiviteteve të përbashkëta. Zgjidhja e konfliktit gjithmonë nënkupton kuptimin e nevojave që qëndrojnë pas qëndrimeve të kundërta. ***Po ashtu, jo çdo konflikt gjatë aktiviteteve të përbashkëta ka bazë etnike edhe pse kjo shpesh mund të jetë supozimi i parë.*** Përgjegjësia e të rriturve është të udhëheqin fëmijët drejt zgjidhjes së konfliktit, në përputhje me kapacitetet e pjesëmarrësve dhe kontekstin. Në intervistat me nxënësit, është përmendur disa herë se pikërisht grindjet rinore kanë paraprirë krijimin e miqësive më të rëndësishme ndërkulturore. Kjo na kujton se konflikti shpesh përmban kontakt autentik mes dy personave — dhe për këtë arsye, potencial për zhvillim më të thellë të marrëdhënies, nëse zgjidhet në mënyrë pozitive.

**Më së shumti kemi mësuar nga gabimet** siç janë ngarkesa e tepërt me detyra në kohë të shkurtër dhe mungesa e hapësirës për reflektim. Herën tjetër, thjesht duhet të përshtatim ritmin dhe strukturën. Shpesh kemi qenë tepër ambiciozë me idetë, metodat dhe detyrat në aktivitetet e përbashkëta — kujtoni: ndonjëherë më pak është më shumë! Është e rëndësishme që nga fillimi të jemi të durueshëm dhe të harmonizojmë deklaratat grupore me dinamikën e përkthimit. Të rinjtë zakonisht mësohen shpejt me ritmin që sjell përkthimi, sepse secilit i intereson të kuptojë dhe të jetë i kuptuar. Është shumë e dobishme të përfshihet ndihma e nxënësve në përkthim, por kujdes që të mos i mbingarkoni. Përkthimi, në fakt, është zakonisht terreni i parë ku zhvillohet durimi, toleranca dhe kureshtja në çdo aktivitet të përbashkët.

**Për kapërcimin e barrierave gjuhësore është e rëndësishme** angazhimi i mësimdhënësve ose nxënësve shumëgjuhësh si ndërmjetësues apo mentorë; përdorimi i materialeve të përgatitura paraprakisht në dy gjuhë dhe me përmbajtje vizuale; përdorimi i gjesteve, mimikës, metodave të thjeshta interaktive; si dhe i teknologjive bashkëkohore — si Google Translate, aplikacione dhe mjete të tjera digjitale që lehtësojnë kuptimin.

**Për aktivitetet e para të përbashkëta rekomandohet** të fillohet me projekte të vogla dhe praktike, të fokusohemi në tema të thjeshta dhe të afërta për të gjithë, në mënyrë që të ndërtohet besimi. Më pas, projektet më të ndërlikuara mund të futen gradualisht.Gjithashtu, është e dobishme të përfshihen mësimdhënës ose nxënës me përvoja pozitive nga aktivitete të mëparshme (nëse është e mundur, të paktën një person që flet të dyja gjuhët), si ndërmjetësues që ndihmojnë në kapërcimin e barrierave gjuhësore dhe modelojnë sjellje bashkëpunuese.

**Pika e nisjes së çdo bashkëpunimi të suksesshëm është** formimi i një ekipi që merr përgjegjësinë për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve. Është e rëndësishme të ekzistojë një ekip i qartë i përcaktuar (mësimdhënës, staf ndihmës, administratë) që planifikon të gjitha aktivitetet e përbashkëta dhe merr përsipër koordinimin logjistik.

**Rol kyç në përhapjen e idesë së aktiviteteve të përbashkëta ndërkulturore ka** ekipi ndërshkollor i mësimdhënësve. Mësimdhënësit që kanë treguar përkushtimin dhe interesimin më të madh për këtë temë përmes aktiviteteve projektuale përfaqësojnë një burim të rëndësishëm për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të nismave ndërkulturore në shkolla dhe komunitet.Nga ana tjetër, është e rëndësishme që ekipi ndërshkollor të ketë mbështetjen e komunitetit shkollor dhe lokal.



**Veçanërisht jemi gëzuar kur** nxënësit zhvillojnë spontanisht bashkëpunim mes vete (kjo nënkupton edhe kur i pëshpëritin njëri-tjetrit përgjigjet gjatë orës) dhe nisin ide kreative. Na gëzon kur vazhdojnë të shoqërohen edhe pas përfundimit të orës së përbashkët.Na emocionon kur të rinjtë që kanë kaluar nëpër aktivitetet tona fillojnë të marrin iniciativa dhe të përfshihen në projekte të përbashkëta brenda komunitetit të tyre.

# "CILI ËSHTË HAPI I PARË I PËRBASHKËT QË NA PRET?" – Për një fillim të ri ndërkulturor

Ftojmë mësimdhënësit dhe shkollat që të ndajnë përvojat e tyre dhe të përfshihen në rrjetin e shkollave që punojnë për zhvillimin e vlerave ndërkulturore. Na dërgoni një tregim nga ndonjë aktivitet i përbashkët, përgatitje të orës, fotografi nga ndonjë punëtori… Lavdërohuni ose ndani një shembull të mirë praktike në:

dragana.georgiev@mpn.gov.rs.

Falënderojmë të gjithë për entuziazmin, përkushtimin dhe guximin për të provuar ide të reja, për të mbështetur njëri-tjetrin dhe për të kontribuar në aktivitetet e përbashkëta. Falënderim të veçantë për të gjithë drejtorët e shkollave partnere, mësimdhënësit, bashkëpunëtorët, nxënësit, prindërit, koordinatorët shkollorë dhe lokalë, trajnerët, përkthyesit, mentorët, si dhe përfaqësuesit e Drejtorisë Arsimit në Leskoc që morën pjesë aktive në projekt, në këtë hulumtim dhe gjatë realizimit të aktiviteteve të përbashkëta. Veçanërisht falënderojmë të gjithë anëtarët e komunitetit lokal që mbështetën veprimtaritë tona të përbashkëta me buzëqeshje dhe fjalë të ngrohta.

*Besojmë se shumë nga këto aktivitete të përbashkëta do të vazhdojnë të jetojnë dhe të zhvillohen në shkollat dhe komunitetet tuaja. Prandaj, këtë nuk e shohim si fund, por si vazhdim i një tregimi të bukur.*



# Pesë propozime të literaturës së dobishme për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme të përbashkëta

Publikime në kuadër të projektit "Qyteti ynë, shkollat tona" – në gjuhën serbe dhe shqipe:

1. Si duken përgatitjet për orë me elemente të ndërkulturalitetit?Në cilat mënyra të tjera mund të identifikohen temat ndërkulturore në arsim?

Shembuj të praktikave të mira në fushën e arsimit ndërkulturor në kuadër të projektit "Qyteti ynë, shkollat tona" (2022)

https://www.grupa484.org.rs/publikacija-primeri-dobre-prakse-u-oblasti-interkulturalnog-obrazovanja/

2. Çfarë përfshin arsimi ndërkulturor dhe cilat janë konceptet kyçe?Cilat janë rezultatet e pritshme të arsimit ndërkulturor? Cilat janë shembuj të përmbajtjeve të mundshme për orët ndërkulturore?

Udhëzues përmes arsimit ndërkulturor (2023)

https://www.grupa484.org.rs/vodic-za-interkulturalno-obrazovanje/

3. Si të gjejmë ekuilibrin mes ngjashmërive dhe dallimeve kulturore?Modeli zhvillimor i ndjeshmërisë ndërkulturore

Bennett, M. J. (2004). Becoming interculturally competent. In J.S. Wurzel (Ed.) Toward multiculturalism: A reader in multicultural education. Newton, MA: Intercultural Resource Corporation.

4. Çfarë nënkupton realisht përfshirja e fëmijëve në një aktivitet të përbashkët? Shkalla e pjesëmarrjes së fëmijëve

Hart, R. A. (1992). Children's participation: From tokenism to citizenship (Innocenti Essays No. 4). UNICEF International Child Development Centre.

5. Çfarë është zona e rehatisë, zona e të nxënit dhe zona e panikut – dhe në cilën zonë ndodh arsimi ndërkulturor?Modeli i daljes nga zona e rehatisë

Lawson, A. (2024, December ) Helping learners to enter and stay in the Learning Zone [Blog]. The Learning Zone.

https://www.thelearningzone.com.au/learning-models-blog/the-learning-zone

LANAC RESURSA GRUPE
SARAJ

ATLA